

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NE SHTERPCE, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.T., nga fsh., Komuna Shtërpçë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PPQ në Prishtinë PP.nr.878-7/09 të dt.26.01.2010, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me dt.07.04.2016, në prani të përfaqësuesit të aktakuzës-Prokurorit të Shtetit Visar Mudsja, të akuzuarit mbrojtësit të tij me aturorizim av.R.G., djemët e të dëmtuarëve F.A. dhe Q.A., të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D.T., data e lindjes....., në Shtërpçë, tani me vendbanim në fsh, Komuna Shtërpçë nga i ati C., e ëma O., e gjinisë M.,serb , shtetas i Republikës së Kosovës,i martuar, ka qenë në paraburgim nga data 15.10.2009 deri me dt.15.11.2009.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me datën 15.10.2009 rreth ores 19:15 në rrugën magjistrale Ferizaj- Shtërpçë, pikërisht në fshatin Bainsë, i pandehuri përderisa ishte duke e drejtuar automjetin e udhëtareve “Opel Astra” me ngjyrë të zezë me tag ate regjistrimit, duke mos ia pershtatur shpejtësinë kushteve të rrugës dhe nga pakujdesia duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 par.1 të LSKRR-së ,ku gjatë vozitjes ka humbur kontrollin ndaj veturës së tij dhe nga shiriti i tij qarkullues del në shiritin e kundërt qarkullues dhe me këtë rast me pjesën e përparme të veturës së tij godet automjetin e udhëtareve “Mercedes 300 E” me ngjyrë të kuqe me targa të cilin ishte duke e drejtuar vozitësi B.A. i cili ishte duke qarkulluar nga ana e kundërt nga Shtërpca në drejtim të Ferizajit me ç’ rast vozitësi i automjetit Mercedes B.A. dhe pasagjerja e tij Xh.A. kanë marr lëndime trupore, nga lëndimet e marra e dëmtaura Xh.A. ka ndërruar jetë në emergjencën e Ferizajit kurse B.A. ka pësuar lëndime të lehta trupore,

Me çka kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit të lartëcekur dhe neneve 3, 6,11,34,36,38,64, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së e

G J Y K O N D E N I M M E B U R G

Të akuzuarin **D.T.** , me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 15.10.2009 deri më dt. 15.11.2009.

Përfaqësuesit e të dëmtuarëve F.A. dhe Q.A. rr.”.....” nr..., për realizimin e kërkeses pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 160 € në afat prej 15 ditëve nda dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokurorisë Publike e Qarkut (PPQ-së) në Prishtinë, me Aktakuzën PP.nr.878-7/09 të dt. 26.01.2010, ka ngarkuar të akuzuarin D.T., nga fsh..... për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par.1 të KPK-së.

Me aktgjykimin P.nr .04/2013 dt. 17.04.2014, sipas aktakuzës së PPQ në Prishtinë PP.nr.878-7/09 të dt.26.01.2010, i akuzuari ishte shpallur fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe të akuzuarin D.T. nga ,e ka shpallë fajtor dhe denuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 15.10.2009 deri më dt. 15.11.2009.

Kundër Aktgjykimi, për shkak të veprës penale në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit, av.R.G., e Gjykata e Apelit e Kosovës PA 1.nr.951/2014 e dt.04.09.2014 ,në seancën e kolegjit e ka anuluar aktgjykimin, dhe çështjen penale i kthenë të njejtës gjykatë në rygjikim dhe rivendosje, me që aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale në dispozitën e nent 384 par 1 pika 1.12 të KPPK-së sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe i pakuptueshëm. Gjyaka ka konvokuar senacë gjyqësore me datën 07.04.2016 , dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor i ka njoftuar palët prezente arësyrat e këthimit në rivendosje përsëri në këtë çështje penale.

Prokurori i shtetit Visar Musa para leximit përsëri të aktakuzës duke i'u përmbajtur udhëzimeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë lidhur me lëshime e lëshuara me rastin e shkrimit të dispozitivit të aktakuzës përkatësisht të dispozitës konkrete të Ligjit të Sigurisë së Komunikacionit Rrugor duke shtuar në rreshtin ekatër të dispozitivit, ku shkruhet mos përshtajtjes së shpejtësisë kushteve të rrugës dhe nga pakujdesia gjatë vozitjes ka vepëruar në kundërshtim me nenin 54 par.1. të LSKRR-së kurse pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e pa ndryshuar e poashtu edhe kualifikimit juridik.

Prokurori i shtetit Visar Musa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës së PPQ në Prishtinë PP.nr.878-7/09 të dt.26.01.2010, në tërësi si në përshkrimin faktik si në dispozitiv dhe përmisimin e bërë në fillim të shqyrtimit gjyqësor dhe kualifikimit juridik të veprës penale që i vëhet në barrë të akuzuarit dhe i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së dënimit ti mere për bazë si rrethanat letësuese poashtu dhe ato rënduese duke patur parasysh

pasojat e shkaktuara nga ky aksidenti, i ka propozuar gjykatës që i njehti të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal konform ligjit.

Gjykata duke vepruar përsëri në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt.07.04.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit Visar Musa, konform nenit 324 të KPPK-së ka lexuar aktakuzën, dhe pasë leximit të aktakuzës dhe mundësisë së të akuzuarit që të konsultohet me mbrotësin e tij gjyqtari gykues në vijim konform nenit 325 par 1 të akuzuarit i ofron mundësi të deklarohet lidhur me veprën penale të pranoj ose të mos pranoj fajsinë.

I akuzuari D.T. në në seancën e rigjykimit përsëri ka deklaruar se e ndien vetën të fajshëm dhe ka pranuar fajsinë për veprën penale që akuzohet dhe në vazhdim i ka shprehur ngushllime dy djemëve që muaren pjesë në seancë tani të ndjerës dhe gjithë familjarët të tyre dhe ka mbetur pranë deklarimeve të dhëna në seancat e më hershme.

Gjykata vlerëson se janë plotësar kriteret nga neni 326 par.4 i KPPK-së çmonë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, në povat dhe atë: ekspertiza ekspertit të komunikacionit e dates 18.12.2009, ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore e datës 20.01.2010 për të dëmtuarit tani të ndjerin B.A., raporti I mjekut në Spitalin e Ferizajit I datës 15.10.2009, në përshkrimin e fotografive të vendit të ngjarjes, dhe në fotot e tjera që gjinden në shkresar e kësaj lënde penale, akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtar konform nenit 352 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Shukri Jashari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet e të cilin pranim e mbështet në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë: dëshmin e të dëmtuarit B.A., ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të dt.18.12.2009 në të cilën vërtetohet se me datën 15.10.2009 rreth orës 19:15 në rrugën magjistrale Ferizaj- Shtërpçë, pikërisht në fshatin Bainsë, i pandehuri përderisa ishte duke drejtuar automjetin e udhëtareve "Opel Astra" me ngjyrë të zezë me tag atë regjistrimit, duke mos ia pershtatur shpejtësinë kushteve të rrugës dhe nga pakujdesia gjatë vozitjes ka humbur kontrollin ndaj veturës së tij dhe nga shiriti i tij qarkullues del në shiritin e kundërt qarkullues dhe me këtë rast me pjesën e përparme të veturës së tij godet automjetin e udhëtareve "Mercedes 300 E" me ngjyrë të kuqe me targa të cilin ishte duke drejtuar vozitësi B.A. i cili ishte duke qarkulluar nga ana e kundërt nga Shtërpça në drejtim të Ferizajit me ç' rast vozitësi i automjetit Mercedes B.A. dhe pasagjerja e tij Xh.A. kanë marr lëndime trupore, nga lëndimet e marra e dëmtaura Xh.A. ka ndërruar jetë në emergjencën e Ferizajit kurse B.A. ka pësuar lëndime të lehta trupore, ku vërtetohet se aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të akuzuarit i ka propozuar gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj një saksion penal të parapar me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.R.G. shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në situatën kur i akuzuari e pranon fajësinë mbrotësi i tij nuk lëshohet në elaborim të fakteve dhe rethanave të gjendjes faktike, dhe pranimin e fajësisë ishte shprehja e vetë vullnetit të të akuzuarit, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqipëtimin të saksionit penal me rastin e matjes së denimit për këtë vepër penale gjykata të vlerësoj dhe të mere për bazë pranimin e fajësisë së klientit të tij dhe se në fillim të seances shpreh keqardhje për atë që i ka ndodhur ku pasë aksidentit është dërguar në paravburgim në kohën prej një muaji gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që të mere për bazë

zbatimin e nenit 66 të KPK-së për zbutje të denimit me që klienti I tij shpreh pendimn për verën penale ngushllimin e familiarëve të të ndejrës.

I akuzuari D.T. në fjalën përfundimtare e akcepton mbrojtjen e të mbreturit të tij në tërsi.

Me që para mbajtes së shqyrtimit gjyqësor i dëmtuari B.A. ka vdekur në shqyrtimin gjyqësor është paraqitur djali i tij F.A. i cili ka deklaruar se i bashkangjitet ndekjes penale kundër të akuzuarit dhe ka mbetur pranë kërkesës pasuroro-juridike të cilën do ta realizon tek Kompania e Sigurimit.

Në bazë të Mendimit dhe Konstatimit të Ekspertit të Komunikacionit Rrugor i dt.18.12.2009 gjykata vërtetoi faktin se deri te aksidenti në ditën kritike ka ardhur për shkak të lëshimeve ekskluzive të bëra nga ana e të akuzuarit me që i akuzuari ka humbur kontrollin ndaj mjetit dhe dalja në anën e kundërt të rrugës në një kthesë për shkak të shpejtësisë së madhe të veturës Opel Astra e të cilën e ka vozitur I akuzuari. Vozitësi i veturës Mercedes nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit.

Gjykata një ekspertizë të tillë i fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është mbështetur në prova dhe fkte, si kallëzimi penal, ashtu edhe nga foto dokumentacioni, dhe provat të tjera që gjinden në shkresat e lëndës.

Në bazë të Mendimit dhe Konstatimit të Ekspertit të Mjekësisë Ligjore dr.T.G. i dt.20.01.2010 gjykata vërtetoi se i dëmtuari B.A. ka pësuar lëndime të leta trupore të konstatuara dhe të përshkruara si në ekspertizë ku këto dëmtime në bazë të dokumentacionit mjekësor të prezentuar, nuk kanë lënë pasojë të përhershme për shëndetin e të dëmtuarit, pra vetëm përkohsisht e kanë dëmtuar shëndetin e tij.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjyka gjeti se i akuzuari e ka shkelur Ligjin mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, dhe nga pakujdesia ka rrezikuar pasurinë dhe jetën e njerëzve duke shkaktuar aksidentin e komunikacionit dhe për pasojë ka ardhur deri te vdekja e të ndjerës Xh.A. ku në verpimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së.

Me rastin e matjës së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 64 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori se i akuzuari ka pranuar fajsinë për veprën penale, në shqyrtimin gjyqësor i shpreh ngushllime palve prezente djalit të të ndjerës dhe familiarëve tjerë i shpreh keqëardhje dhe ngushllime për atë që i ka ndihodhur dhe për atë që nuk ka mundur që të merr pjesë në varrimin e të ndjerës me që ishte dërguar në qendrën e paraburgimit nuk ka të dhëna se më heret të ketë qenë i gjykuar me aktgjykim të forms së prerë, ka shpreh pendim të thellë për verën e kryer nga koha e aksideti e deri më tani është i ngarkuar me stres psiçikr, mbajtes i familjes vlerësimin e sjelljeve të akuzuarit pasë kryerjes së kësaj vere penale, sjelljen korrekte gjatë procedurës penale, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, bi bazen e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikëshmerinë konkrete të kësaj vere penale të akuzuarin e denoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 15.10.2009 deri më dt. 15.11.2009, duke qen

e bindur se se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventives special dhe asaj gjenerale conform nenit 34 të KPK-së.

Gjykata vlerësoj edhe porpozimet e mbrojtësit të të akuzuarit që merastin e shqiptimit të sanksionit penal të zbatohet dispozitat ligjore të neneve 66 dhe 67 të KPPK-së, pra të aplikohet dispozitat për zbutje të denimit por gjykata pas analizës së të gjitha provave që ka në këtë çështje penale nuk ka shkakur në zbutje të denimit pos masës më të ult të denimit që parashifet për për këtë vepër penale.

Në bazë të nen. 463 par. 2 të KPPK-së gjykata përfaqësuesen ligjor i të ndjerës djain e saj F.A. rr.”.....” nr..., për realizimin e kërkeses pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nen. 450 par.2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së gjykata të pandehurin e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 100 € si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 60 €.

Nga e gjithë sa u thekësua u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHITËRPCË
P.nr .71/2014 dt. 06.04.2016

Asistyenti,
Muedin Rexhepi

Gjyqtari,
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimet nëpërmjet kësaj gjykate.